

Për shpërblimin e këshillave, komisioneve dhe ekspertizave të veprimtarisë shkencore dhe teknologjisë

Numri i ligjit: 567

Vendim i KM 23.10.1995 23.10.1995

Statusi i ligjit: Në fuqi

Fushat e veprimit të aktit: I Papërcaktuar

Propozuar nga: Komiteti i Shkencës dhe Teknologjisë

Për shpërblimin e këshillave, komisioneve dhe ekspertizave të veprimtarisë shkencore dhe teknologjisë

REPUBLIKA E SHQIPERISE

Këshilli i Ministrave

VENDIM

Nr.567 datë 23.10.1995

PËR

SHPËRBLIMIN E KËSHILLAVE, KOMISIONEVE DHE EKSPERTIZAVE TË VEPRIMTARISË SHKENCORE DHE TEKNOLOGJIKE

Me propozimin e Komitetit të Shkencës dhe Teknologjisë,

Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Anëtarët e këshillave, komisioneve dhe ekspertizave të ngritura pranë Komitetit të Shkencës dhe Teknologjisë, Akademisë së Shkencave dhe ministrive me V.K.M. nr.424, datë 6.8.1993 "Për krijimin e Këshillit të Politikës Shkencore dhe të Zhvillimit Teknologjik dhe riorganizimin e Komitetit të Shkencës dhe Teknologjisë", pika 1, nr.158, datë 7.4.1995 "Për disa ndryshime në V.K.M.nr.424, datë 6.8.1995 pika 1/b, nr.222, datë 15.5.1995 "për sistemimin e informacionit dhe dokumentacionit shkencor e teknik" dhe udhëzimeve të

Numri i ligjit: 567

Vendim i KM 23.10.1995 23.10.1995

Për shpërblimin e këshillave, komisioneve dhe ekspertizave të veprimtarisë shkencore dhe teknologjisë

Komitetit të Shkencës dhe Teknologjisë nr.634, datë 8.9.1994, nr.2, datë 30.9.1994, nr.3, datë 30.9.1994 "Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik", neni 10, paragrafi i tretë, për veprimtarinë shkencore dhe teknologjike përfitojnë të drejtën e shpërblimit.

2. Anëtarët e Këshillit të Politikës Shkencore dhe Zhvillimit Teknologjik shpërblehen në masën 2000 lekë për çdo mbledhje.
3. Anëtarët e Këshillit të Informacionit e Dokumentacionit Shkencor e Teknik shpërblehen në masën 1500 lekë për çdo mbledhje.
4. Anëtarët e Komisioneve këshillore pranë Komitetit të Shkencës dhe Teknologjisë shpërblehen në masën 1000 lekë për mbledhje.
5. Anëtarët e grupeve të hartimit të Programeve Kombëtare të Kërkimit e Zhvillimit dhe anëtarët e grupeve të ekspertizave që bëjnë vlerësimet e pranimit të Programeve Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit të Projekteve në zbatim të tyre, si dhe ekspertët që bëjnë vlerësimet afatmesme dhe përfundimtare të projekteve shpërblehen me vlerën e plotë të kohës së punës në ditë, të shpenzuar për kryerjen e detyrës përkatëse, e cila caktohet me kontratë ndërmjet organit financues dhe Programit Kombëtar të Kërkimit e Zhvillimit dhe anëtarëve të grupit përkatës. Vlera e kohës së punës në ditë njësohet me atë të profesorit (drejtues kërkimesh).
 - Kryetarët e grupeve për hartimin e Programeve Kombëtare të Kërkimit e Zhvillimit dhe të grupeve të ekspertizave marrin një shtesë prej 5% të shpërblimit su anëtare.
 - Anëtarët e komisioneve të ngritura pranë Komitetit të Shkencës dhe Teknologjisë, Akademisë së Shkencave, ministrive dhe institucioneve qendrore, për miratimin e projekteve të zbatim të Programeve Kombëtare të Kërkimit e Zhvillimit shpërblehen në masën 1500 lekë.
 - Pagesa për anëtarët e komisioneve, grupeve të hartimit të ekspertizave të Programeve Kombëtare të Kërkimit e Zhvillimit të projekteve në zbatim të tyre bëhen nga fondet e miratuara të Programeve Kombëtare pranë institucioneve përgjegjëse për to me miratimin e titullarit të institucionit ku ato ngrihen.
6. Përfitojnë të drejtën e shpërblimit vetëm ata persona të këshillave dhe komisioneve që nuk janë punonjës të organit që i ngre ato dhe që nuk e kanë për detyrë funksionale pjesëmarrjen në to. Përrjashtim bëjnë ekspertizat.
7. Pagesat sipas këtij vendimi indeksohen në raport me rritjen e pagave nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
8. për pikën 2 të këtij vendimi efektet financiare fillojnë nga data 1janar 1995.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
ALEKSANDËR MEKSI